STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 14 mars 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON RIMBURSIMIN FEDERAL PER FSHATIN E FRIPORTIT (FREEPORT) PER KOSTOT E SUPERS STUHISE SENDI (SANDY)

Guvernatori drejton mbi 600,000 dollarë në fonde të miratuara nga FEMA tek Friporti (Freeport) për kostot e pastrimit pas super stuhisë Sendi (Sandy)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Shteti i Nju Jorkut (New York State) ka siguruar 624,869 dollarë për Fshatin e Friportit (Freeport) në Qarkun Naso (Nassau County) për rimbursimin e kostove të pësuara nga fshati pas pasojave të super stuhisë Sendi (Sandy). Fshati i Friportit (Freeport) përdori punë, pajisje, material, pajisje të mara me qira dhe shërbime të kontratave për të hequr mbeturinat nga rrugët dhe pronat publike.

"Ndikimi i Sendit (Sandy) krijoi sfida të konsiderueshme për komunat anembanë rajonit metropolitan të Qytetit të Nju Jorkut (New York City), Long Ajlënd (Long Island) dhe Luginës së Poshtme të Hadsonit (Lower Hudson Valley)," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Komuniteteve vendore si Fshati i Friportit (Freeport) iu desh të vepronin shpejt, të hiqnin mbeturinat e stuhisë dhe të përpiqeshin të rimëkëmbeshin sa më shpejt që të ishte e mundur. Jam shumë i gëzuar që jam në gjendje të drejtoj këto fonde përsëri tek fshati dhe t'i ndihmoj ata të vazhdojnë në përpjekjet e tyre të përgjithshme për rimëkëmbje. "

"Super stuhia Sendi (Sandy) pati pasoja shkatërruese në Fshatin e Friportit (Freeport). Fshati ka shpenzuar burime të konsiderushme për t'u rindërtuar dhe për t'u rimëkëmbur nga dëmi sa më shpejt që të jetë e mundur. Ky fond rimbursimi do të jetë në përfitim të madh për Fshatin e Friportit (Freeport) dhe do të mbështesë përpjekjet e tij të vazhdueshme të rimëkëmbjes," tha Senatori Çarls J. Fushilo, Jr (Charles J. Fuschillo, Jr).

Anëtari i asamblesë Brajan Kuran (Brian Curran) tha, "Shteti i Nju Jorkut (New York State) dhe Long Ajlënd (Long Island) janë duke parë më në fund një pjesë të parave që qeveria federale na premtoi për ndihmën për Sendin (Sandy) muaj më parë. Ndërsa Nju Jorku (New York) administron këto fonde federale, jemi të gëzuar që të rimbursojmë më në fund komunat vendore për punën e jashtëzakonshme të tyre për të rikthyer dhe rindërtuar pas Sendit (Sandy). Super stuhia la pas shkatërrim në Qarkun tim të

Asamblesë; jam krenar që të sigurohem se Shteti i Nju Jorkut (New York State) vazhdon të mbajë premtimin tone për të ndihmuar në rimëkëmbjen e komuniteteve dhe familjeve tona që punojnë."

"Rikthimi i komuniteteve të dëmtuara nga super stuhia Sendi (Sandy) është përparësia më e lartë e departamentit tonë dhe këto fonde të Ndihmës Publike do të ndihmojnë secilin nga komunitetet e prekura që të rivendosin në rregull punët fiskale të tyre," tha Komisioneri i Seksionit të Sigurisë së Atdheut dhe Shërbimeve të Urgjencës të NYS-së (NYS Division of Homeland Security and Emergency Services Commisioner) Xherom M. Hauër (Jerome M. Hauer).

Dhënia e këtyre fondeve federale është pjesë e rimbursimeve në vazhdim dhe në pritje në të ardhmen që shteti do të administrojë dhe paguajë tek komunat e prekura. Komunat janë duke u rimbursuar mbështetur në një shumëllojshmëri projektesh që përfshijnë ndërtimin dhe shkatërrimin, heqjen e mbeturinave ranore dhe bimore, aktivizime të EOC-së, largime, kontrolle dhe riparime dhe rivendosje emergjente të teknologjisë së informacionit dhe programin Strehimi dhe Energjia Thelbësore e Përkohëshme (Sheltering and Temporary Essential Power) (STEP). Shteti do të vazhdojë t'i bëjë këto pagesa të rimbursimeve ndërsa FEMA jep fondet.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418